



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr 1680 Prot

Vlorë, më 26.01 2026

Lënda: Njoftim për mbledhjen e radhës të Këshillit të Bashkisë, datë 30.01.2026.

ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË BASHKISË VLORE

**Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË VLORE
PREFEKTIT TË QARKUT VLORE**

Ju njoftoj se, **ditën premte, datë 30.01.2026, ora 10:00**, në Pallatin e Kulturës “Labëria” do të zhvillohet mbledhje e radhës e Këshillit të Bashkisë Vlorë, e thirrur nga Kryesia e Këshillit, në bazë të Ligjit Nr. 139/2015, neni 53 pika 4, ku pas ;

1. Shprehje për ligjshmërinë e Vendimeve të Këshillit të Bashkisë Nr 99 - 109, datë 23.12.2025 .
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes të Këshillit të Bashkisë, për muajin Dhjetor , datë 23.12.2025.

Do të vazhdojmë me këtë rend dite:

1. Projektvendim “Për dhënien e mandatit të këshilltarit, znj. Rozina Xhevit Kormuzi”.
2. Projektvendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë, për muajin Dhjetor 2025”.
3. Projektvendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Dhjetor 2025”.
4. Projektvendim “Për miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike , nga fondi i kushtëzuar, për bllok - ndihmën , si dhe nga fondet e buxhetit vendor”.
5. Projektvendim “Miratimin për shtimin e veprimtarisë “Administrimi, menaxhimi dhe shfrytëzimi i plazheve publike” në objektin e Shoqërisë “Vlora Parking Sh.A”

6. Projektvendim “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB Nr 100, datë 23.12.2025”Për Buxhetin e Bashkisë për Vitin 2026”.
7. Projektvendim” Për miratimin e marrëveshjes së partneritetit midis Bashkisë Milano dhe Bashkisë Vlorë, në kuadër të projektit “AQVA NOSTRA – 013244/01/2”.
8. Projektvendim “Për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit midis programit për zhvillim të Kombeve të Bashkuara dhe Bashkisë Vlorë, si dhe metodologjinë për alokimin e fondeve për organizatat e shoqërisë civile”
9. Projektvendim “Për miratimin e marrëveshjes së partneritetit në kuadër të projektit “Smart Cities/6038897” Intereg – VI IPA CBC, Programi Grece – Albania 2021 – 2027”
10. Informacion, mbi raportin vjetor të veprimtarisë dhe vendimmarrjes së Këshillit të Bashkisë Vlorë, për periudhën 1 Janar – 31 Dhjetor 2025.
11. Të Ndryshme.

Kryesia e Këshillit të Bashkisë, u mbledh në mjediset e Bashkisë Vlorë, datë 26.01.2026, ora 12:00.

Komisionet e përhershme, do të mbledhen në mjediset e Bashkisë Vlorë, si më poshtë :

Komisioni juridik, i rendit dhe i sigurisë vendore publike, do të mbledhet ditën e mërkurë , datë 28.01.2026 , ora 10:00.

Komisioni për çështjet e ekonomisë, financave dhe privatizimet, do të mbledhet ditën e mërkurë, datë 28.01.2026, ora 11:00.

Komisioni i shërbimeve publike, transportit, infrastrukturës dhe strehimit, do të mbledhet ditën e mërkurë, datë 28.01.2026, ora 12:30.

Komisioni i Mandateve dhe Rregullores, do të mbledhet ditën e mërkurë, datë 28.01.2026 , ora 13:30.

V.O. Bazuar në rendin e ditës të sipërcituar, nëse ndonjë nga Komisionet e Përhershme, vlerëson se, duhet të mbledhet për çështjet që trajtojnë projektvendimet, Kryetari i Komisionit të njoftojë anëtarët e komisionit përkatës, për datën dhe orën e mbledhjes.

KRYETAR

Elpiniqi Mërkuri

**ME URDHËR DHE DELEGIM
NËNKRYETAR**

Novrus Rrokaj

